



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq



Zyra e Kryetarit
Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	12/08/ 2025
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës z.Xhafer Gashi
Për/Za/To:	- Kryesuesen e Kuvendit Vlora Mjekiqi –Kabashi - Anëtarët e Kuvendit Komunal
Tema/Subjekat/Subject	Raporti Janar – Qershor 2025

**Përshëndetje e nderuara Kryesuese,
Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,**

Ju lutem që në mbledhjen e Kuvendit Komunal në muajin Gusht të shqyrtoni:

**RAPORTIN E PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT
KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2025**

Ky raport është i ndarë në tri pjesë:

- Raporti i Ekzekutivit
- Raporti i DEFZH
- Raporti i Zyrës së Prokurimit

Ju faleminderit për bashkëpunim!

2025



KOMUNA OBILIQ
OPSTINA OBILIQ
MUNICIPALITY OBILIQ

RAPORTI GJASHTË MUJOR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT KOMUNAL

Janar –Qershor 2025

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

XHAFER GASHI

**Qytetarë të Obilqit,
Anëtarë të Kuvendit Komunal,**

Si rezultat i punës sonë gjashtëmujore me angazhim maksimal në shërbim të qytetit dhe fshatrave, ju paraqes raportin gjashtëmujor për vitin 2025. Ky raport përmbledh projektet e realizuara, arritjet e shënuara, sfidat me të cilat jemi përballur dhe planet për të ardhmen.

Gjatë kësaj periudhe kemi hartuar buxhetin së bashku, kemi monitoruar zbatimin e tij dhe kemi ndarë së bashku gëzimin për investimet e realizuara. Raporti pasqyron angazhimet tona të përbashkëta në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, kulturë, rini e sport, pavarësisht sfidave financiare.

Vitet 2024 dhe 2025 kanë qenë një barrë e rëndë për buxhetin komunal. Vendimet përmbartimore që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit kanë sjellë ekzekutimin e mjeteve në vlerë prej **2,620,906.39 €** vetëm në këtë periudhë. Në total, nga kjo kontratë janë ekzekutuar deri tani **3,551,385.92 €**. Kjo është një sfidë e madhe buxhetore që na ka penguar në realizimin e plotë të planit të punës.

Megjithatë, raporti financiar gjashtëmujor tregon një performancë të jashtëzakonshme të hyrave komunale, duke tejkaluar planin me **61.92%**.

Raporti gjashtëmujor është një mjet i rëndësishëm për transparencën e plotë dhe llogaridhënien tonë para jush. Që nga viti 2023 kemi zbatuar formën e re të hartimit të buxhetit – ***Buxheti me pjesëmarrje të qytetarëve*** – i cili këtë vit është zhvilluar në tërë territorin e Komunës së Obilqit.

Gjatë kësaj periudhe kemi marrë pjesë në konferenca ndër komunale, rajonale dhe ndërkombëtare. Një ndër to ishte konferenca e mbajtur në Bruksel nga Komiteti Evropian i Rajoneve, ku u themelua grupi për Kosovën. Konferenca me temën ***“Ndërprerja e degradimit mjedisor – Veprimet lokale dhe marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Kosovës”***.

Sfida e mjedisit ka mbetet njëra ndër sfidat me të mëdha për ne, sidomos përballë ndotjes dhe emetimeve të gazrave nga KEK-u dhe rrezikut nga zjarret fushore në një ndër verat më të nxehta.

Viti 2025 është vit zgjedhor. Pas zgjedhjeve nacionale, është caktuar data e zgjedhjeve lokale në tetor. Ne kemi ofruar të gjithë mbështetjen institucionale të nevojshme për KQZ-në, si për procesin zgjedhor të shkurtit, ashtu edhe për atë të tetorit.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore, donatorët dhe organizatat tjera ka qenë i vazhdueshëm.

Partnerët tanë përfshijnë OSBE-në, DEMOS-in, GIZ-in, KFOR-in, ambasadat, Bankën Botërore dhe Bashkimin Evropian.

Takimet :

Takime javore me Bordin e Drejtorëve

- Takime të rregullta të AKK-së
- Takime të rregullta me KKSB-në
- Takime të vazhdueshme me qytetarët
- Takime me delegacione vendore dhe të huaja, përfshirë homologë kryetarësh komune

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

Së bashku kemi arritur ta realizojmë planin e punës dhe ta menaxhojmë buxhetin në mënyrën më të mirë të mundshme. Ju kemi raportuar rregullisht çdo tre muaj për gjendjen financiare, dhe ky raport gjashtëmuor është vazhdim i këtij angazhimi për transparencë.

Përmbledhje

Fjala e Kryetarit	2
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme-	4
DSHPE –	06
Drejtoria e Arsimit -	08
DSHMS -	18
Drejtoria e Inspekcionit	35
DKRS –	37
DMM –	40
DBZHR -	41
Drejtoria e Infrastrukturës Lokale –	42
DPUPK –	44
Njësia e Burimeve Njerëzore –	49
Zyra ligjore -	51
Njësiti Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore	52

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Raport gjashtëmuor Janar – Qershor 2025

Drejtorja e Administratës, në kuadër të kompetencave të saj dhe në përputhje me legjislacionin dhe aktet normative në fuqi, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim të qytetarëve, por edhe për nevoja të brendshme institucionale të Komunës së Obiliqit.

Gjatë kësaj periudhe, është punuar me profesionalizëm për të qenë sa më afër qytetarëve dhe për të ofruar zgjidhje për çdo çështje të adresuar pranë kësaj drejtorie.

Përmirësimi i shërbimeve për qytetarët

- Vendosja e **kutisë së ankesave dhe lëvdatave** në hyrje të objektit të komunës, për të marrë komente nga qytetarët.
- Funksionalizimi i **E-kioskut** në Komunën e Obiliqit – shërbime 24 orë në ditë.
- Lansimi i **platformës së re të aplikimeve online**, që u mundëson qytetarëve aplikimin nga shtëpia pa ardhur fizikisht në zyrat komunale.

Spektori i Administratës së Përgjithshme

- Kryen punët profesionale dhe juridike për Kuvendin dhe komitetet obligative.
- Mbikëqyr punët e QSHQ-së (Qendra e Shërbimeve për Qytetarë).
- Përgatit vendime sipas kërkesave të Kryetarit, prokurimit dhe njësisve kërkuese.
- Përgjigjet në kërkesat e qytetarëve drejtuar Kryetarit dhe Bordit të Drejtorëve.

Në kuadër të këtij sektori janë:

Kuvendi, QSHQ-ja, Arkiva, Logjistika dhe Teknologjia Informative.

Kuvendi Komunal

- 6 mbledhje të rregullta dhe 3 seanca solemne.
- Komiteti për Politikë dhe Financa – 6 mbledhje.
- Komiteti për Komunitete – 6 mbledhje.
- KKSBB (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi) – 3 mbledhje.
- Përkthim shqip–serbisht dhe anasjelltas për të gjitha materialet e Kuvendit, komiteteve, rregulloreve, vendimeve, konkurseve etj.

Qendra e Shërbimeve për Qytetarë dhe Arkiva

- Kryerja e punëve të përditshme për pranim–dorëzim të kërkesave, dhënia e informacionit dhe këshillimit për qytetarët, protokollim dhe dorëzim të lëndëve.
- Lëndë të dorëzuara për palët/institucionet e jashtme: **420**.
- Lëndë të pranuar nga posta e jashtme: **2,466**.

Statistikat për periudhën raportuese:

- Pranuar – 1
- Të miratuara – 7,157
- Të refuzuara – 361
- Të hedhura poshtë – 3
- Të pezulluara – 3
- Të ceduara – 14
- Të anuluar – 14
- Të përfunduara – 8,468
- **Gjithsej** – 17,551 lëndë

Logjistika

- Regjistrim dhe inventarizim në e-pasuri për Drejtoritë DKRS, DA etj.
- 134 lëndë të futura në SIMK (hyrje në thesar) nga zyra e prokurimit.
- Realizim i hyrje–daljeve nga depoja për administratën, institucionet arsimore dhe shëndetësore.
- Furnizim me material administrativ përmes e-pasurisë dhe hyrjeve në thesar.

Teknologjia Informative

- 52 formatizime dhe instalime për kompjuterët e rinj.
- Ndërhyrje teknike në institucionet komunale, shëndetësi dhe arsim.
- 85 kyçje në SIMBNJ dhe 185 qasje në HRMIS System.
- 22 ndërrime kompjuterësh dhe përditësim i versioneve.
- Incizimi dhe transmetimi online i mbledhjeve të Kuvendit përmes teleprezencës në MAPL dhe kyçje në CMS.
- Regjistrim i 185 lëndëve në SIMFK – Pasuri.

Sektori i Gjendjes Civile

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar gjithsej **9,973** dokumente:

- Ekstrakte lindjeje – 5,541
 - Certifikata lindjeje – 1,684
 - Certifikata martese – 1,026
 - Certifikata vdekjeje – 389
 - Certifikata vendbanimi – 300
 - Deklarata bashkësie familjare – 796
 - Certifikata statusi martesor – 164
 - Certifikata shtetësie – 32
 - Vërtetime nga arkiva – 41
-

Projektet e Drejtorisë së Administratës

Sipas kontratave të AQP:

- Furnizim me material administrativ dhe për zyra.
- Furnizim me ujë.
- Shërbime me aparate fotokopjeje dhe printer për institucionet komunale.

Projektet e brendshme:

- Shërbime avokatie.
- Shërbime bufes komunale.
- Mirëmbajtje e objekteve të komunës.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Aktivitetet për vitin 2025

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës (DSHPE) promovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të shërbimeve publike dhe koordinon aktivitetet ditore, javore dhe mujore në funksion të ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Aktivitetet kryesore të planifikuara për vitin 2025 janë si më poshtë:

- Menaxhimi i situatave emergjente
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit dimëror

- Përgatitja e stafit dhe dokumenteve bazë për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe rreziqeve tjera
- Mirëmbajtja dhe deblokimi i rrjetit të kanalizimeve
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik
- Vendosja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal
- Ofrimi i shërbimeve të recepsionit në objektin e Kuvendit Komunal
- Ndërtimi i hapësirave për komunitet
- Digjitalizimi i rrugëve dhe objekteve publike në Komunën e Obiliqit
- Transporti publik lokal
- Subvencionimi për përmirësimin e kushteve të banimit

kërkesa të trajtuara nga DSHPE

Gjatë periudhës raportuese janë pranuar gjithsej **463 kërkesa** nga qytetarët, operatorët ekonomikë, KEDS-i, KRU Prishtina dhe palë të tjera. Nga këto:

- **452 kërkesa** janë shqyrtuar
- **401 kërkesa** janë miratuar
- **51 kërkesa** janë refuzuar
- **11 kërkesa** janë ende në proces
- Janë lëshuar gjithashtu **15 pëlqime** të natyrave të ndryshme
- Janë subvencionuar 3 familje nga to 1 për sigurimin e vendbanimit, 1 për renovimin e shtëpisë, 1 për sanimin e dëmeve nga të reshurat atmosferike.

DSHPE ka trajtuar edhe raste të intervenimit në deblokimin e kanalizimeve në qytet dhe fshatra, në bashkëpunim me kompaninë publike KRU Prishtina (njësia në Obiliq).

Kontratat e menaxhuara (nga vitet e kaluara deri në qershor 2025)

1. Rrënimi i objekteve, pastrimi i mbeturinave ilegale, pastrimi i shtratit të përroskave/lumenjve dhe shërbime tjera emergjente
2. Fshirja, larja dhe mbledhja e mbeturinave në rrugë, trotuare, shirita të gjelbër dhe sheshe
3. Shërbime recepsioni (“Kontrata në Shtëpi”)
4. Sigurimi i veturave zyrtare
5. Shërbime të autolarjes dhe vullkanizimit
6. Furnizimi me karburant (benzinë/dizel) – Regjioni i Prishtinës
7. Shtruarja e rrugëve me zhavorr
8. Vendosja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal
9. Mirëmbajtja e ndriçimit publik në territorin e komunës
10. Rregullimi dhe sanimi i dëmeve në objektet publike komunale
11. Mirëmbajtja e hapësirave publike në komunën e Obiliqit

Të dhëna të tjera për periudhën Janar – Maj 2025

- **Shpenzimet për derivate:**
 - Sasia: 9,538.47 litra
 - Shuma: 10,862.50 €

- **Shpenzimet për energjinë elektrike:** 68,424.72 €
- **Shpenzimet për ujë:** 1,810.57 €
- **Shpenzimet për mbeturina:** 33,026.02 €

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit gjashtëmujorin e vitit 2025 e ka filluar mbi zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025 - 2029 (me Nr.01-060-01-36654-2024, datë 29.11.2025), i cili ka marrë miratim të ligjshmërisë nga MASHTI, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm me Nr.8/382, datë 06.02.2025.

Gjatë kësaj periudhe DA punët dhe detyrat i ka kryer në bazët të Planit të Punës për vitin 2025 dhe detyrat tjera në kordinim me bashkëpunime tjera si me MASHTI-in ashtu edhe kolegje, institute, OJQ etj. Janë mbajtur takimet e rregullta me Bordin e Drejtorëve Komunal, drejtorët e institucioneve arsimore, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, punëtorët e DA-së, kolegjiunet e komunave dhe takimet me OJQ-të e bashkëpunëtorët tjerë për projektet e arsimit. Janë lidhur disa marrëveshje për zhvimin e arsimit dhe zhvillimin profesional të mësimeve (Fakulteti i Edukimit, OJQ Toka, Kolegji Universum, kolegji AAB, Teach for Kosova, programi KosEd etj).

Nga nëpunësit civil të DA-së janë hartuar planet e punës për vitin 2025. Gjatë muajit shkurt 2025 janë kryer vlerësimet e punëtorëve për vitin 2024 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBN-HRMIS). Janë vlerësuar edhe drejtorët e zëvendësrejtorët e SHFMU dhe SHML sipas legjislacionit në fuqi.

Në bashkëpunim me MASHTI-in, Komuna e Obiliqit ka përruar Institucionin e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme në Milloshevë më 10.01.2025, i cili do të fillojë punën nga data 01.09.2025.

Organizimi i procesit mësimor

Arsimi në Komunën e Obiliqit organizohet në katër nivele 0,1,2,3. Mirëpo, këtë vit përqëndrimi sipas Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025 - 2029 do të jetë në këto fusha:

- Gjithëpërfshirja në Arsim;
- Mësimdhënia dhe të nxënit;
- Zhvillimi profesional i mësimeve;
- Udhëheqja dhe menaxhimi;
- Mjedis dhe kultura institucionale.

Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 08.01.2025, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHTI-it nr.04/2024. Nxënësit e klasëve të dymbëdhjeta (maturantët) kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë më 15.05.2025, nxënësit e klasëve të 9, 10 dhe 11 kanë përfunduar mësimin me 05.06.2025, ndërsa nxënësit e klasëve 1-8 dhe fëmijët parafillor kanë përfunduar mësimin më 23.06.2025.

Numri i nxënësve këtë vit shkollor është katërmijë e tetëdhjetë (4080) nxënës sipas komuniteteve: shqiptarë janë 3442, serbë 226, romë 232, ashkali 178 dhe boshnjakë 2 nxënës.

Janë gjithsej **221** paralele, prej tyre 20 paralele me parafillor; 94 paralele janë në nivelin 1-5; në nivelin 6-9 janë 75 paralele dhe në nivelin 10, 11 dhe 12 janë 32 paralele.

Paralele në shkollat fillore me mësim në gjuhën serbe janë: 35 paralele; prej tyre me parafillor 2 paralele, 1-8 janë 25 paralele dhe në shkollën e mesme 1 - 4 janë 8 paralele.

Krahasuar vitin shkollor 2024/2025 me vitin shkollor 2023/2024 kemi 221 nxënës më pak. Gjatë vitit shkollor 2024/2025 deri në 31 mars 2025 kanë mërguar 21 nxënës dhe një mësimdhënëse. Mirëpo, në Komunën tonë në zonën e interesit nacional ka pasur zhvendosje të banorëve nga fshatrat Shipitullë dhe Siboc.

Orët e planifikuara, të realizuara dhe të pa mbajtura gjatë vitit shkollor 2024/2025

Institucionet edukativo-arsimore	Orët e planifikuara	Orët e realizuara	Orët e pambajtura
SHFMU dhe SHML	186607	183922	2685

Numri i nxënësve në institucionet edukativo-arsimore për vitin shkollor 2024/2025

[illegible]

10	Gjimnazi "17 Shkurti"	Obiliq	101	193	294	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	295
11	SHFMU "Fazli Graiçevci"	Hade e Re	25	12	37	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	37
12	SHFMU "Fazli Graiçevci" 1	Lajthisthtë	43	37	80	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	80
13	SHFMU "Fazli Graiçevci" 2	Palaj	18	21	39	0	0	0	10	11	21	0	0	0	0	0	0	60
14	SHFMU "Pandeli Sotiri"	Obiliq i Vjetër	97	83	180	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	180
15	SHFMU "Pandeli Sotiri" 1	Plemetin	20	12	32	0	0	0	54	60	114	0	0	0	1	0	1	147
16	SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova"	Obiliq	450	456	906	1	1	2	9	10	19	0	0	0	0	0	0	927
17	SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" 1	Mazgit i Epërm	82	72	154	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	154
18	SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" 2	Mazgit I Poshtëm	110	103	213	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	213
19	SHFMU "Sveti Sava "	Plemetin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	29	28	57	73	88	161	218
20	SHFMU "Millan Rakiq"	Babimost	0	0	0	0	0	0	0	0	0	28	30	58	0	0	0	58
21	SHFMU "Dositej Obradoviq"	Palaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20	24	44	0	0	0	44
22	SHMLP "Sveti Sava "	Plemetin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	30	37	67	30	40	70	137
Gjithsej			1814	1628	3442	1	1	2	85	93	178	107	119	226	104	128	232	4080

**TË PUNËSUARIT NË INSTITUCIONET
ARSIMORE QERSHOR 2025**

Nr	Shkolla	Drejtor		zv.drejtor		Bibliotekiste		Sekretar		Psikolog		Asistent		Edukatore		z.Administrativ		P.teknik		Mësimdhënës		Servisuese/Kuzhinjere		Femra	Mashkuj	Gjithsej
		F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M			
1	IP"Rrita Jonë"	1												1	0	1		1				2		15	0	15
2	"Dr.Ibrahim Rugova"	1			1	1		1		2		3		1	0			1	8	63	7			82	16	98

3	“Hasan Prishtina”		1		1					1		1		2				3	4	32	6			39	12	51
4	“Pandeli Sotiri”		1								1		4					2	3	19	3			26	7	33
5	“Naim Frashëri”	1												1					3	15	8			16	13	28
6	“Migjeni”		1			1							2						3	12	8			15	12	27
7	“Abdurrahmon Gërguri”		1										1					1	1	11	2			13	4	17
8	“Fazli Grajqevci”	1									1		3						3	25	4			30	7	37
9	“Gjimnazi Shkurti” 17	1																1	1	11	7			12	8	21
10	“Ismail Dumoshi”		1			1	1	1		1								2	4	24	13			29	19	48
11	“Sveti Sava”																			7	5			7	5	12
12	“Dositej Obradoviq”																	1	1		3			1	4	5
13	“Milan Rakiq”																	2	4	3				5	4	9
	Gjithsej	5	5		2	3	1	2		4		6		3 2	1	1		14	3 5	222	66	2		29 0	111	401

Numri i punëtorve të arsimit në qershor 2025 është **401 punëtorë**, prej tyre 10 drejtorë, 2 zëvendësrektor, 288 mësues, 33 edukatore, 1 punëtor administrativ, 2 sekretare, 4 bibliotekiste, 3 psikologe, 1 logoped, 6 asistente për fëmijët me nevojë të veçantë, 2 administratë, 49 punëtorë teknikë.

Subvencionet e Drejtorisë së Arsimit për vitin shkollor dhe akademik 2024/2025

N r.	Ndarja e subvencioneve	Numri i konkurruesëve	Numri i përfituesëve	Mjetet e ndara	Meshkuj përfitues të subvencioneve	Femra përfituese të subvencioneve
1	Bursa për nxënës të SHML me sukses të shkëlqyeshëm	90	76 (nga 150 €)	11,400.00 €	25	51
2	Bursa për studentë të nivelit bachelor	198	149 Sipas 5 kategorive	61,650.00	42	107
3	Bursa për studentë të nivelit master	64	45 (nga 700 €)	31,500.00 €	14	31
4	Bursa të nivelit të doktoraturës	5	3 (nga 1200 €)	3,600.00 €	2	1

5	Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës me nevoja të veçanta	32	32	30,150.00 €	19	13
6	Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të SHFMU dhe SHML	861	709 (nga 130 €)	92,170.00 €	330	379
Gj :		1250	1014	230,470.00 €	432	582

Gjatë kësaj periudhe janë bërë pagesat për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës dhe nxënës me nevoja të veçanta, bursave të nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm për shkollat e mesme të larta dhe studentëve të niveit bachelor, master dhe doktoraturë për vitin shkollor dhe akademik 2024/2025.

Studentja **Elmedina Mexhuani**, Fakulteti i Edukimit – programi edukimi i hershëm, notën mesatare 9.97 më të lartë gjatë studimeve dhe ka fituar çmimin “Adem Preniqi” në vlerë prej 700.00 €.

Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Arsimit për vitin shkollor 2024/2025 organizon transportin edhe për një numër të nxënësve; në vlerë prej 10,049.16.92 € (prej tyre 6,990.72€ për nxënës të SHFMU “Migjeni” në Graboc dhe 3,058.44€ për nxënës të SHFMU “Fazli Grajçevci” Hade e Re për nxënës që jetojnë në Zonën e Interesit Nacional të shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Graboc). Në Shipitullë janë 7 nxënës që barten në SHFMU “Migjeni” në Graboc, që vijnë në mësim. Transporti organizohet edhe për nxënës që janë të rrezikuar në komunikacion, të cilët janë të lagjes Isufaj - Hade e Re, ku janë 16 nxënës.

Për transportin e nxënësve shqiptarë dhe serbë janë edhe dy minibusa të komunës, të cilët bartin edhe 260 nxënës; nga Babimoci janë 85 nxënës, Llazareva 35 nxënës dhe 35 nga Lagjja Grajçevci në Obiliq dhe në SHFMU “Hasan Prishtina” në Milloshevë. Nga vendbanimi Njana Voda në Palaj në SHF “Dositej Obradoviq” barten edhe 20 nxënës serbë vetëm në një ndërrim (kthehen pas mësimit me kombibus). Po ashtu me këta kombibus komunal barten edhe 85 nxënës të SHMLP “Ismail Dumoshi” në Obiliq, të cilët ndjekin praktikën në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK).

Menaxhimi i programit të intranetit janar-qershor 2025

Në programin e intranetit gjatë muajve janar-qershor 2025 janë regjistruar 734 kërkesa, janë pranuar të gjitha nga DA, të miratuara janë 541 kërkesa, të refuzuar 78, të anuluar 2, të transferuara në drejtoritë tjera 11 dhe në proces janë 102, kryesisht kërkesa të konkursit për pranimin e fëmijëve në IP “Rrita Jonë “në Obiliq për vitin shkollor 2025/2026 (Konkursi është mbyllur më 25.06.2025) dhe shkresa të ndryshme nga arkivi komunal, të cilat janë në shqyrtim.

Konkurset, rekrutimet dhe vlerësimet e performances së drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve të shkollave fillore të mesme të ulta gjatë periudhës janar/qershor 2025

Gjatë periudhës janar-qershor janë publikuar 3 konkurse, për 4 pozita dhe janë përzgjedhur 5 mësimdhënës, prej tyre; komisioni vlerësues dhe përzgjedhës ka përzgjedhur një mësuese klase, zëvendësim i pushimit të lehonisë në SHFMU "Fazli Grajçevci" në Hade të Re, një mësimdhënëse e biologjisë në Gjimnazin 17 "Shkurti" në Obiliq nga konkursi i publikuar në vitin 2024, konkurset për dy mësimdhënës të matematikës në SHFMU "Pandeli Sotiri" në Obiliq, paralelja në Plemetin dhe "Migjeni" në Siboc, paralelja në Graboc të Epërm, konkursi për mësuese klase, zëvendësim i pushimit të lehonisë në SHFMU "Hasan Prishtina" në Milloshevë. Konkursi për nëpunës të TIK-ut në DA është shpallur tri herë, por nuk ka pasur kandidatë të kualifikuar. Gjatë muajit shkurt 2025 kanë hyrë në listat e pagave edhe 8 edukatore, të cilat kanë qenë të testuara dhe intervisutara nga konkursi i viti 2024. Për konkursin e publikuar për SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" në Obiliq, për vendin e punës mësimdhënës i gjuhës shqipe në paralelen në Mazgit të Poshtëm janë duke u zhvilluar procedurat e vlerësimit, ku ka përfunduar vlerësimi i testit me shkrim. Po ashtu është përgatitur edhe projekt –propozimi për një zyrtar mbështetës në DA në fushën e sociologjisë.

Bazuar në Udhësimin Administrative nga MASHTI me NR.106 /2020 për Vlerësimin e Performancës së Drejtorit dhe Zëvendësrejtorit Të Instituconit Publik Arsimor Parauniversitar, nga DA janë vlerësuar dy drejtorë dhe dy zëvendësrejtore; në SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" në Obiliq, vlerësimi i zëvendësrejtorit, në SHFMU "Hasan Prishtina" në Milloshevë është kryer vlerësimi i drejtorit dhe zëvendësrejtorit dhe në SHFMU "Pandeli Sotiri" në Obiliq ka përfunduar vlerësimi i drejtorit. Formularët e vlerësimit të performances së tyre janë dërguar në SIA në Prishtinë, e cila do të vazhdojë edhe vlerësimin i tyre.

Trajnimet

- Në SHFMU "Pandeli Sotiri" në Obiliq po vazhdon projekti nga fondi i Bashkimit Evropian me KosEd, projekti "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë", ku ka përfunduar vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i shkollës.
- Komuna e Obiliqit ka nënshkruar marrëveshjen për trajnimin e 20 mësimdhënësve me Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, ku projekti realizohet në bashkëpunim me Institutin për Hulumtim dhe Zhvillim në Arsim, në kuadër të Fakultetit të Edukimit, Universiteti "Hasan Prishtina" dhe OJQ-së, Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim (TOKA). Projekti është emëruar implementimi i metodologjisë së të nxënësve përmes përvojës në klasë, si dhe fuqizimin e mësimdhënësve në përdorimin e metodologjive interaktive të mësimdhënies.
- Gjatë kësaj periudhe janë trajnuar 67 mësimdhënës, të cilët kanë kryer këto trajnime: Edukimi për drejtësi shoqërore, ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve (KEC); Movie EQ Moviq/iom (IOM); Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë (KosEd); Të nxënësve përmes përvojës (TOKA dhe Fakulteti i Edukimit); Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënien dhe Administrimi i Portalit të Edukimit (SBSHK-u); Classroom Digital Tools From Inovative Teachers And Students-Hamilton Hause; Intiligjenca artificiale (Kolegji Univerzum) dhe

(Ambasada Franceze); Rishikimi i testeve shkollore (Instituti Pedagogjik dhe KosEd); analizimi i steriotipeve dhe promovimi i arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë (Colors of Humanity); Breathing new Life into our lessons (Person Education); Diskriminimi në bazë të kontnitetit (Play Intertnacional Kosovo); The Teacher`s Chapter-Beyond the classroom (Dukagjini dhe Person); Ngritja e kapaciteteve për rishikim dhe përmirësim të tekstve shkollore (MASHT, DKA < EU-KOSED dhe IPK); Administrimi, menaxhim dhe udhëheqje në arsim (QAPA), etj.

Projektet e DA për 2025, (kontratat e nënshkruara me prokurimin):

1. Furnizimi dhe vendosja e mjeteve sportive dhe rekuizita në IEA;
2. Furnizimi dhe montimi i mbishkrimeve në institucionet komunale - reklama ndriçuese për objektet komunale në Obiliq;
3. Dru dhe pelet për IEA;
4. Pemë dhe perime për IP “Rrita jonë” në Obiliq;
5. Vazhdimi i projekteve me NPL “Kastrioti “Kontrata në Shtëpi” për renovime dhe mirëmbajtje të IEA;
6. Shtuarja e dysHEMEVE të klasëve të shkollës dhe salla sportiv me epoxit në SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq (Donator Qeveria Japoneze, projekt i fituar nga drejtoresha e shkollës “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq, janë përfunduar klasët, ka mbetur të rregullohet edhe salla e edukatës fizike, (vazhdimi i projektit nga viti 2024).

Në procedurë të projektimit:

1. Rregullimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së TI-së për “Digjitalizimin në institucionet Edukativo-Arsimore” . Mjetet janë marrë nga përmbaruesi në nivelin qendror për pagesat e punëtorve të arsimit sipas Kontratave Kolektive.

Aktivitetet 2025:

Kremtimi i 7 Marsi - Dita e Mësuesit, 138 vjetori i Mësojtores së Parë Shqipe (Korçë 1887)

Jemi Komuna që vitin e kaluar dhe këtë vit kemi fituar dy çmime “Shaban Jashari “ në nivel vendi për mësimdhënës më të dalluar.

Mësimdhënësi Shaip Krasniqi ka fituar çmimin tradicional “Shaban Jashari” 2025 nga MASHTI-i dhe nga Drejtoria e Arsimit çmimin “Mësimdhënës i dalluar “ 2025 në nivel komunal.

Komuna e jonë me Drejtorinë e Arsimit, për të nëntëmbëdhjetën herë me radhë kanë ndarë çmimin tradicional “Mësimdhënës i dalluar” 2025. Deri tani ky çmim u është ndarë 118 edukatorëve e mësimdhënësve. Mirënjohje janë ndarë për të gjithë pensionistët e vitit 2024 siç janë: Znj. Shyhyrete Gashi - drejtore nga SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq, znj. Drita Qorri - pedagoge nga SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq, z. Mentor Aliji mësues klase nga SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq, zonj. Vahide Kurteshi mësimdhënëse e edukatës fizike nga SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq, znj. Fatime Hashani kuzhinjere në IP “Rrita Jonë” në Obiliq, z. Enver Hashani mësimdhënës i kimisë nga SHMLP “Ismail Dumoshi” në Obiliq, znj. Bahrije Prokshi mësimdhënëse e ekonomisë nga SHMLP “Ismail Dumoshi” në Obiliq, z. Hamit Doda

mësimdhënës i praktikës profesinale nga SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq, znj.Zojnije Krasniqi mësuese klase nga SHFMU "Pandeli Sotiri" në Obiliq, z.Shemsi Thaqi mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe nga SHFMU "Migjeni" në Siboc dhe z.Fatmir Mjeku edukator nga SHFMU "Migjeni" në Siboc, paralelja në Graboc. Mirënjohje pas vdekjes iu nda z.Enver Krasniqi punëtor teknik në SHFMU "Naim Frashëri" në Breznicë, paralelja në Kozaricë.

Drejtorja e Arsimit duke e vlerësuar dhe çmuar punën e mësimdhënësve më të dalluar, të cilët po na nderojnë me punën e tyre edhe në nivel të vendit, Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në këtë ditë të rëndësishme për arsimin shqiptar ka marrë vendim që mësimdhënësit, të cilët fitojnë çmime në MASHTI për punën e tyre do të shpërblehen edhe nga Komuna e Obiliqit. Andaj, nderohet me mirënjohje dhe çmim mësimdhënësi i TIK-ut z.Nusret Zeka nga SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" në Obiliq, i cili vitin që shkoi fitoi çmimin tradicional "Shaban Jashari" nga MASHTI. Pra, nga Komuna jonë u fitua ky çmim dy vite radhazi.

Këshillat e Mësimdhënësve në Institucionet Arsimore për t'i përzgjedhur edukatorët e mësimdhënësit për çmimin mësimdhënës i dalluar janë mbështetur duke vlerësuar këto kritere: Vlerësimin e performances së mësimdhënësit, kualifikimin e mësimdhënësve; përvojën e punës së paku 7 vjet në procesin edukativo-arsimor; punët dhe detyrat e realizuara të cilat kanë reflektuar në procesin edukativo-arsimor; puna dhe rezultatet që e veçojnë nga të tjerët; organizimi i mësimi shtues-plotësues me nxënës që kanë ngecje në mësim; zhvillimi i rregullt i takimeve me prindër dhe këshillin e arsimtarëve; organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve jashtë kurrikulare; raportet dhe bashkëpunimet me kolegë, drejtuesit e institucionit dhe prindërit, si dhe trajnime profesionale të përfunduara të cilat janë të akredituara dhe licensuara nga MASHTI. Po ashtu shkollat ju kanë bërë thirrje të gjithë mësimdhënësve që të konkurrojnë për çmimin mësimdhënës i dalluar në nivel të shkollave.

Komisioni komunal i përbërë nga drejtorët e Institucioneve Edukativo-Arsimore: Ismail Shalaku kryetar, Ragbeta Gashi anëtare dhe Jakup Hashani anëtar, kanë analizuar dhe vlerësuar 11 dosje të mësimdhënësve konkurrues për çmimin "Mësimdhënës i dalluar" 2025. Ky komision ka përzgjedhur mësimdhënësin më të dalluar në nivel komune, i cili është fitues i çmimit tradicional "Mësimdhënës i dalluar" 2025 në nivel komunal. Komisioni ka vendosur që mësimdhënës i matematikës z.Shaip Krasniqi nga SHFMU "Naim Frashëri" në Breznicë të konkurrojë edhe për çmimin tradicional "Shaban Jashari" në MASHTI.

Komisioni në takimin e fundit me drejtorë, në raportimin e tyre ka cekur se dosjet më të kompletuara dhe më të vlerësuara pas asaj që fitoi çmimin ishin edhe ato të mësimdhënësve të dalluar znj. Liridona Saraçi Beka nga SHFMU "Fazli Graçevci" në Hade dhe mësimdhësi i dalluar z.Fuad Hashani nga SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq.

Me mirënjohje nderohen edhe mësimdhënësit e dalluar, të cilët janë përzgjedhur nga shkollat si mësimdhënës më të dalluar, të cilët janë: motër edukatorë Mimoza Sallova Aliu nga IP "Rrita jonë" në Obiliq; mësuesja Begishe Mecinaj nga SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" në Obiliq; mësuesja Fikrete Spahijaj Pllana nga SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" në Obiliq; mësuesi Behxhet Mehmeti SHFMU "Hasan Prishtina" në Milloshevë; mësimdhënësi i edukatës fizike Ardian Stullçaku SHFMU "Pandeli Sotiri" në Obiliq; mësimdhënësja e gjuhës angleze Liridona Sarçi Beka SHFMU "Fazli Graçevci" në Hade; mësimdhënësi i historisë Jeton Sadiku SHFMU "Migjeni" në Siboc; mësimdhënësi i biologjisë dhe kimisë Driton Gashi SHFMU

”Abdurrahmon Gërguri“ në Dardhishtë; mësimdhënësja e biologjisë Albulena Hashani Gjimnazi “17 Shkurti “ në Obiliq dhe mësimdhënësi i TIK-ut Fuad Hashani nga SHMLP “Ismail Dumoshi “ në Obiliq.

Organizimet dhe mbajtja e testeve

- Testin Ndërkombëtar PISA 2025, ku kanë marrë pjesë 117 nxënës, prej tyre 65 nxënës nga SHML dhe 52 nxënës nga SHFMU
- Testi i Maturës Shtetërore 2025, më 21.06.2025, ku kanë marrë pjesë 315 nxënës
- Testin e Arritshmërisë 2025 më 27.06.2025, ku kanë marrë pjesë 346 nxënës
- Rezultatet e Testit të Maturë 2025 janë publikuar 30.06.2025, të cilat janë: Gjimnazi”17 Shkurti” në Obiliq, numri i nxënësve pjesëmarrës 95, kalueshmëria e tyre 83.16 % (për afatin e gushtit 2025 kanë mbetur 16 nxënës) ndërsa SHMLP ”Ismail Dumoshi“ në Obiliq, numri i nxënësve pjesëmarrës 100, kalueshmëri e tyre 36 % (për afatin e gushtit 2025 kanë mbetur 64 nxënës).

Organizimet e garave

Garat e diturisë - Janë organizuar garat në nivel të shkollave dhe komunale për; Olimpiadën e Matematikës 2025; Olimpiadën e Fizikës 2025, Olimpiadën e përbashkët Kosovë - Shqipëri për Gjuhën Shqipe me klasë të nënta 2025, ku 9 nxënës kanë kaluar testin dhe kanë marrin pjesë në garat në nivel të Republikës së Kosovës. Poashtu nxënësit tanë kanë pasur suksese edhe në garën e gjuhës angleze - gara Spelling Bee. Gara do të organizohen edhe nga Olimpiada e Kimisë 2025, ku do të mbahet me nxënës të klasëve të 10,11 dhe 12.

Dy nxënës që vet kanë konkurruar në gara ndërkombëtare në matematikë dhe TIK janë caktuar të marrin pjesë në Barcelonë. Janë këta Diell Sadiku klasa e 8 në SHFMU ”Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq, që ka fituar në garën për matematikë dhe Ari Salihu SHMLP ”Ismail Dumoshi” në Obiliq që ka fituar për garën në teknologji informatike.

Drejtorja e Arsimit për t`i mbështetur nxënësit dhe mësimdhënësit që arrijnë suksese do të bëjë plotësim-ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktivitetet jashtëshkollore.

Shpenzimet buxhetor për gjashtëmuor në disa kategori janar – qershor 2025

	Arsimi Parafill	Arsimi Parafillor	Arsimi i mesëm	Arsimi Fillor.mes	Drejtoria e Arsimit	Arsimi fillor	Arsimi fillor	Arsimi i mesëm	Arsimi i mesëm	Arsimi fillor	Donacion për SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq
	Mallra dhe shërbime	Komunalit	Subveconet	Kapitalet	Mallra dhe shërbime	Mallra dhe shërbimet	Komunalit	Mallra dhe shërbime	Komunali	subvencio.	Qeveria Japoneze
Buxheti- 10	14,500.00	2,000.00	150,000.00		58,421.00	153,759.00	15,000.00	53,250.00	15,000.00	150,000.00	19,881.50
Buxheti 21	9,000.00			370,191.00	10,000.00						
Buxheti- 22											
21											
Zotime	4,423.64	1,734.71	92,291.00	0.00	67,896.26	8,043.25	3,988.14	208.75	4,997.48	148349.50	0.00
Mbetje	10,076.36	265.29	57,709.00	0.00	524.74	145,715.75	11,011.86	52,832.50	10,002.52	1650.50	19,881.50

**Suksesi i nxënësve shqiptarrë, ashkali e boshnjakë
në gjysëmvjetorin e parë të vitit shkollor
2024/2025**

Komuna Obiliq	Klasë	Shkëlqyeshëm			Sh. mirë			Mirë			Mjafueshëm			Me dy nota të dobëta			Të pa notuar				Me një notë të dobët			Me tri e më shumë nota të dobëta			Kanë përsëritur klasën			Përcillen me nota negative			Gjithsej
		M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	F	M	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj		
	Klasa 1	87	77	164	24	16	40	5	4	9	3	1	4	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	220
	Klasa 2	86	83	169	27	25	52	14	8	22	6	4	10	2	0	2	0	0	0	0	0	0	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	257
	Klasa 3	52	63	115	28	20	48	26	17	43	6	6	12	0	1	1	0	1	1	2	0	2	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	224
	Klasa 4	36	41	77	25	21	46	22	17	39	8	3	11	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	175
	Klasa 5	53	75	128	34	34	68	23	16	39	12	4	16	0	1	1	0	0	0	1	6	7	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	261
	Klasa 6	23	51	74	24	28	52	29	29	58	2	2	4	3	15	18	0	1	1	15	6	21	20	9	29	0	0	0	0	0	0	0	257
	Klasa 7	21	48	69	28	41	69	33	13	46	9	2	11	10	13	23	0	0	0	25	11	36	34	6	40	0	0	0	0	0	0	0	294
	Klasa 8	16	37	53	15	33	48	23	21	44	5	2	7	10	12	22	0	0	0	12	9	21	45	11	56	0	0	0	0	0	0	0	251
	Klasa 9	16	31	47	11	30	41	23	20	43	2	3	5	7	15	22	0	1	1	9	5	14	37	3	40	0	0	0	0	0	0	0	213
	Klasa 10	5	13	18	13	29	42	13	17	30	3	2	5	10	10	20	5	2	7	22	12	34	38	10	48	0	0	0	0	0	0	0	204
	Klasa 11	4	19	23	17	20	37	15	19	34	6	1	7	2	13	15	8	2	10	15	19	34	35	8	43	0	0	0	0	0	0	0	203
	Klasa 12	6	19	25	13	21	34	11	14	25	11	0	11	1	21	22	2	0	2	9	19	28	44	6	50	0	0	0	0	0	0	0	197
	Gjithsej	405	557	962	259	318	577	237	195	432	73	30	103	45	103	148	15	7	22	110	87	197	256	59	315	0	0	0	0	0	0	0	2756

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIREQENIES SOCIALE

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Drejtoria e shëndetësisë dhe mireqenies sociale në kuadër të përgjegjësisë të veta ka kryer punë dhe detyra të shumta.

Memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Obiliqit dhe Kompanisë Medica në Prishtinë me një mamograf digjital në QKMF.

Kujdesi Parësor Shëndetësor ka funksionuar duke u bazuar në Statutin e QKMF-së ,dhe atë me : 1 (një) QKMF në Obiliq ,1 (një) QMF në Milloshevë dhe 4 (katër) AMF (Breznicë, Babimoc,Plemetin dhe Siboc).

Këshilli drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ,mbajtjes së disiplinës ,orarit të punës.

Shërbime shëndetësore cilësore 24/7.

Vizita të vazhdueshme monitoruese të gjitha njësive të QKMF-së.

Vizita në shtëpi për nënat shtatzëna dhe fëmijët deri në moshën tre vjeçare.

Furnizim me material shpenzues mjekësor.

Furnizim me material për shërbime laboratorike.

Furnizim me pajisje stomatologjike.

Furnizim me material higjienik.

Furnizim me material administrativ, administrativo-shëndetësor.

Pranimi i testeve antigjene në QKMF.

Asgjësim i barnave dhe mbetjeve mjekësore në QKMF.

Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF-së.

Vaksinimi i rregullt për fëmijët e grup moshave të caktuara sipas kalendarit të vaksinimit si dhe vaksinimi i nxënësve.

Vaksinimi i nxënësve të klasëve të gjashta me vaksinën kundër kancerit të qafës së mitrës (HPV).

Fluorizimi i nxënësve të klasëve të gjashta të të gjitha shkollave të Komunës së Obiliqit.

Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së.

Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit.

Përgatitje e specifikave për procedura prokurimi.

Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve të KPSH, Inventarizimi.

Ekipet mjekësore të QKMF-së kanë asistuar dhe mbështetur aktivitetet kulturo-sportive.

Takime të përditshme me qytetarë.

Janë kryer punët e përditshme tekniko - administrative (fatura, kërkesa, etj.)

Vizita për personat në gjendje të rëndë shëndetësore ,ata të cilët për shkak të gjendjes nuk mund të shkojnë te mjeku, ku i ofrohen të gjitha shërbimet (dhënia e terapisë, marrja e gjakut etj).

KËRKESAT PËR NEVOJA SHËNDETËSORE DHE SOCIALE
(JANAR-QERSHOR 2025)

Të aprovuara	339
--------------	-----

KËRKESAT PËR NËNAT LEHONA
(JANAR-QERSHOR 2025)

Të aprovuara	50
--------------	----

Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e QKMF-së dhe QPS-së, përmes zyrës së prokurimit, ka iniciuar këto procedura:

Titulli i projektit	Vlera
Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim në institucionet publike (DDD)	20,208.90 €
Asgjësim i barnave me afat të skaduar dhe mbetjeve mjekësore	2,112.00 €
Furnizim me material administrativ për QKMF	1,300.00 €
Furnizimi me oksigjen medicinal	2,493.40 €
Furnizim me material higjenik	4,990.55 €

RAPORTI I SHPENZIMEVE
(JANAR-QERSHOR 2025)

MALLRA DHE SHËRBIME	ZOTIM
Karburante për vetura	12,947.02 €
Internet	116.07 €
Mirëmbajtja e dozimetrave	40.00 €
Shërbime kontraktuese	4,226.23 €
Furnizim me material mjekësor	39,402.00 €
Furnizim me Oksigjen	1,102.60 €
Furnizim me material administrativ	3,997.85 €
Asgjësimi i barnave me afat të skaduar dhe mbetjeve mjekësore	2,920.00 €
Regjistrimi i veturave	315.00 €
Mirëmbajtja e hapësirave publike	22,112.38 €
Dezinfektim, Deratizim,Dezinsektim në institucionet publike komunale	1,000.00 €
Furnizim me mjete higjienike	2,638.50 €
Patty Cash	500.00€

SHPENZIMET KOMUNALE	SHPENZIM
Rrymë elektrike	14,211.16 €
Ujë	1,632.19 €

QKMF

Gjatë kësaj kohe këshilli drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, disiplinës, orarit të punës etj.

Në QKMF janë trajtuar një numër i madh i pacientëve dhe janë ofruar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve (shih tabelën)

NUMRI I PACIENTËVE DHE NUMRI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Nr.	QENDRA KRYESORE E MJEKËSIS FAMILJARE	Numri i pacientëve	Numri i shërbimeve mjekësore
1.	QKMF Obiliq	45758	124388
2.	QMF Milloshevë	3629	20381
3.	QMF Plemetin	851	4346
4.	AMF Siboc	1033	3633
5.	AMF Breznicë	1238	2047
6.	AMF Babimoc	1361	4961
	TOTALI:	53870	159756

REFERIMET

JANAR QERSHOR 2025

	QKMF -Obiliq		Nr. i referimeve <u>PËR KONSULTIM</u> <u>Enë</u> kujdesin tretësor	Nr. i referimeve <u>eNË DIAGNOS</u> <u>TIKËN</u> e kujdesit tretësor	Nr i referim eve në <u>QENDR ËN EMERG JENTE</u>	Gjithsej Udhëzim e për Kujdesin tretësor	Numri i përgjiths hëm i vizitave mjekësor e	Përqindja (%) e të referuarve në kujdesin tretësor
	Njësia	Depart.						
1	QKMF Obiliq	Mjekësi Familjare	3017	793	259	4069	20587	19.7%
2	QKMF Obiliq	Urgjenca	163	0	1226	1389	10143	13.6%
3	QKMF Obiliq	Pediatrica	153	17	5	175	2157	8.1%
4	QKMF Obiliq	Gjinekologjia	91	141	0	232	992	23.3%
5	QKMF Obiliq	Kujdesi paliativ	20	10	7	37	1412	2.6%
6	QKMF Obiliq	Shëndeti oral	13	68	0	81	1196	6.7%
7	QMF Milloshevë	Mjekësi Familjare	522	35	17	574	2625	21.8%
8	QMF Milloshevë	Shëndeti Oral	0	0	0	0	0	
9	AMF Plemetin	Mjekësi familjare	17	0	0	17	851	1.99%

10	AMF Siboc	Mjekësi Familjare	115	19	2	136	1033	13.1%
11	AMF Breznicë	Mjekësi Familjare	145	5	4	154	1238	12.4%
12	AMF.Babim oc	Mjekësi Familjare	401	41	0	442	1361	32.4%
			4657	1129	1520	7306	43595	16.7%

Të dhënat për sëmundjet masive jo infektive

- 1.F00,F04,F05 ,F09,F20,F30,F31,F32.3,F33,F22,F29,F84,G71(shëndetit mental)
- 2.E10-E14,(sëmundjes së sheqerit)
- 3.I00-.I02,I20,I21,I24,I25(sëmundjeve kardiovaskulare)
- 4.N05(nefropatit)N03,N04,N05,N10,N18
- 5.J42,J45,J47 ,(sistemit respirator)
- 6.D65-D69,C-(sëmundje malinje),

Sëmundjet	Numri
I10	95
I20, I21, I24, I25	0
E10-E14	89
J42, J45, J47	6
N03, N04, N05, N10, N18	2
F00-F48	2
D65-D69	0
Sëmundjet malinje	3

Numri i referimeve në nivelin sekondar	4657
Numri i referimeve në diagnostikë	1129
Gjithsej pacientë	43595

Janar-Qershor janë dorëzuar gjithësej këto fletëparaqitje

Sëmundje masovike jo ngjitëse	201
Sëmundje malinje	3

Raportimet ditore

Sëmundjet e traktit Respirator	8292
Sëmundjet e qarkullimit të gjakut	3208

Sëmundjet ngjitëse

Pneumonia	21
Diare	53
Variqellë	4
Dyshim në grip	310
Dyshim në fruth	0
Dyshim në tularemi	0

Raport i numrit të pacientëve sipas shërbimit nga Web Aplikacioni – QKMF

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	
Gjinekologjia	883
Kujdesi Paliativ	234
Laboratori	1524
Mjekësia Familjare	14168
Pediatra	0
Rëntgen	0
Shëndeti Oral	2360
Shërbimi Emergjent	2360

Njësia: Qendra e Mjekësisë Familjare në Milloshevë	
Mjekësia familjare	1972
Shëndeti oral	1040

Njësia: Ambullanta e Mjekësisë Familjare Siboc	
Mjekësia Familjare	960

Njësia: Ambullanta e Mjekësisë Familjare Breznicë	
Mjekësia Familjare	384

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA NË QKMF

DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Nr.	Sektori i mjekësisë familjare	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	20587
	Gjithsej shërbime	32402

Nr.	Këshillimorja për personat me diabet dhe hipertension	Nr. i shërbimeve
1.	Nr. i pacientëve	754
	Gjithsej shërbime	2038

Nr.	Vizitat shtëpiake për nënën dhe fëmijët deri në 3 (tre) vjet (Takime virtuale)	Nr. i shërbimeve
1.	Nr. i vizitave në shtëpi	137
2.	Nr. i fëmijëve të përfshirë në vizitë	128
3.	Nr. i shtatzënave të përfshirë në vizitë	9
4.	Nr. i rasteve të Komunitetit Rom Ashkalinj të përfshirë në vizitë	20
5.	Puna në grupe “Klasat për Nëna”	224

SEKTORI I KUJDESIT EMERGJENT

Nr.	Kujdesi Emergjent	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	10143
	Gjithsej shërbime	17359

KUJDESI PALIATIV

Nr.	Kujdesi Emergjent	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1412
	Gjithsej shërbime	4868

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr.	Njësia e SISH	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të regjistruar	0

Nr.	Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacienteve në qendër dhe teren	3000
	Gjithsej shërbime	5707

Nr.	Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit	Nr. i shërbimeve
1.	Dhënia e vaksinave	1448
2.	Shërbime tjera	1259

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

Nr.	Shëndeti Oral	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve	1196
	Gjithsej shërbime	6291

SEKTORI KONSULTATIV

Nr.	Njësia e Pediatriisë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2157
	Gjithsej shërbime	4665

Nr.	Njësia e Gjinekologjisë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	992
	Gjithsej shërbime	2685

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

Nr.	Laboratori	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve	2711
	Totali i parametrave të punuara	36983

	RTG	Nr. i shërbimeve
1.	Nr. i pacientëve	949
	Gjithsej shërbime	3984

Nr.	Ultrasonografi	Nr. i shërbimeve
1	Nr. i pacientëve	170
	Gjithsej shërbime	525

Nr.	Barnatorja në QKMF,QMF,AMF	Nr. i shërbimeve
	Gjithsej pacientë	2016

	Gjithsej receta	4676
--	-----------------	------

MJEKËSIA FAMILJARE NË TEREN

Nr.	QMF Milloshevë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2625
	Gjithsej shërbime	5138

Nr.	AMF Plemetin	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	851
	Gjithsej shërbime	4346

Nr.	AMF Siboc	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1033
	Gjithsej shërbime	3929

Nr.	AMF Breznicë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1238
	Gjithsej shërbime	2037

Nr.	AMF Babimoc	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1361
	Gjithsej shërbime	4961

Nr.	Sektori i Diagnostikës –Laboratori në QMF Milloshevë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1004
	Gjithsej shërbime	15243

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i administratës këtë vit ka funksionuar pa ngecje. Në vazhdimësi është raportuar në baza ditore, javore, mujore, është mbajtur evidenca rreth vijueshmërisë të punëtorëve. Organizimi i pushimeve vjetore, përpilimi i listave të kujdestarive në vazhdimësi janë përpiluar nga Kryeshefi i Dep. të MF, Shefi i Administratës në bashkëveprim me Kryeinfermieren.

TË HYRAT NGA PARTICIPIMI

Data e dorëzimit (Janar-Qershor)	Shuma	Vendi ku janë dorëzuar
Gjithsej	16067 €	NLB

RAPORT I KARBURANTEVE

Periudha	Benzinë	Diesel
Janar –Qershor		5630 litra

NJËSIA PËR SHËRBIME TEKNIKE

Sa i përket furnizimit me material higjienik ka qenë i kënaqshëm. Higjiena ka qenë në nivel të duhur-me vërejtje të kohëpaskohshme.

BARNATORJA QËNDRORE

Furnizimi me barëra brenda periudhës janar-dhjetor ka qenë i kënaqshëm. Kemi mungesë të madhe me barna nga lista esenciale e barnave. Barërat që kanë arritur në barnatore janë shpërndarë vazhdimisht nëpër QMF dhe AMF. Kërkesat për barëra nga lista esenciale janë dorëzuar në korporatë me rregull. Po ashtu vlen të përmendet se furnizimi me insulinë ka qenë në nivel të kënaqshëm.

ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (ZHVP)

Në QKMF në kuadër të ZHVP-së u mbajtën tridhjetë (30) ligjërata për mjek dhe infermier, ligjërata këto të aprovuara nga OMK dhe OIK.

Jashtë qendrës u mbajtën trajnime dhe takime dhe atë me pjesëmarrje 30 mjek dhe 66 infermier.

EDUKIMI DHE PROMOVIMI SHËNDETËSOR

AKTIVITETET

Sesione informuese për nxënësit dhe mësime për nxënësit e klasave të gjashta, me temën “Me vaksinën anti HPV si dhe pasojat e virusit. Po ashtu u dhanë informata rreth Kancerit të qafës së mitrës, pjesëmarrës 305.

Me date 26/02/2025 në fshatin Plemetin në shtëpinë e kulturës u mbajt e Sesion informues për rendësin e vaksinimit në komunitet; Në takim ishin 12 pjesëmarrës. Organizator QKMF Obiliq, Balcan Sun Flowers, UNICEF. Ligjeratën e mbajti Dr Rejhane Musliu.

“Dita botërore e Shëndetit” me 07 Prill u shënuar nga punëtorët e QKMF Obiliq me c’rast një ekip në shesh u ofroj kalimtarëve të rastit matjen e peshës, përcaktimin e IMT, matjen e TA dhe shpërndau lufleta rreth jetës së shëndetshme.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

OFRIMI I NDIHMËS SOCIALE

JANAR – QERSHOR 2025

Sipas kushteve dhe kriterëve që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndihmave Sociale për periudhën raportuese, numri i familjeve është:

Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes së SNS-së në periudhën :

Muaji	Nr. i familjeve në SNS	Anëtarët e familjes në SNS	Shuma në €
Janar	508	2,106	67,370.00 €
Shkurt	507	2,083	66,450.00 €

Mars	509	2,085	66,800.00 €
Prill	505	2,007	66,450.00€
Maj	489	1,997	64,060.00€
Qershor	491	2,006	64,180.00€
Total			394,310.00 €

Janar- Qershor 2025 kemi këto:

Aplikime, Riaplikime, Riaktivizime dhe Ndërprerje.

Muaji	Aplikime	Ri aplikime	Riaktivizime	Ndërprerje
Janar	4	62	5	6
Shkurt	3	54	1	9
Mars	6	76	1	9
Prill	2	60	0	5
Maj	2	62	1	16
Qershor	3	60	0	14

Lëndët e komisionit mjekësor për periudhën Janar-Qershor 2025.

Muaji	Lëndët e aprovuara nga komisioni mjekësor	Lëndët e refuzuara nga komisioni mjekësor	Total
Janar	21	0	21
Shkurt	29	5	34
Mars	28	4	32

Prill	34	1	35
Maj	31	3	34
Qershor	18	5	23

Më datën 24.03.2025 dy donator Musa Demaj dhe Faton Demaj kane dhuruar nga 150 € gjithsejt 300 € për 6 familje te varfura sociale ne vlere nga 50 €.

Më datën 26.03.2025 gjatë muajit ramazan kemi shpërnda pako ushqimore për 150 familje me raste te renda sociale nga Shoqata Humanitare Freskia.

Me datën 09.06.2025 është bërë shpërndarja e mishit nga 5 kg për 180 familje nga Shoqata Islamic Relief.

RAPORT I SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 në shërbimet sociale dhe familjare janë paraqitur gjithsej **421** raste:

1. Fëmijë pa kujdes prindëror - **18**
2. Strehim familjar tek të afërmit – **13**
3. Kërkesa për adoptim vendor - **3**
4. Kërkesa për adoptim ndërkombëtar -**1**
5. Fëmijë i keqtrajtuar - **8**
6. Fëmijë me sjellje asociale - **6**
7. Përdoruesit e substancave narkotike- **Nuk ka të dhëna**
8. Puna e rrezikshme –**Nuk ka të dhëna**
9. Rrëmbim ndërkombëtar I fëmijëve -**0**
10. Të miturit në konflikt me ligjin - **25**
11. Viktimat e dhunës në familje -**11**
12. Viktimat e trafikimit- Nuk ka të dhëna (Viktimë e trafikimit po konsiderohen edhe rastet që detyrohen për lypsari)-**6**
13. Viktima e krimeve seksuale - **2**
14. Martesa e të miturve - **2**
15. Këshilla martesore (Divorc) - **15**
16. Të moshuarit – **1**
17. Fëmijë me papërgjegjësi penale **13**
18. Klient të tjerë:

- a. Me probleme familjare -**20**
- b. Nën timer vetushqyese -**7**
- c. Personat me aftësi të kufizuar/Që i është hequr zotësia e veprimit -**10**
- d. Fëmijë me aftësi të kufizuar -**68**
- e. Aftësia e prindërve nuk është adekuate për përkuqdesje ndaj fëmijës

F/1. Vertetim për armëmbajtje - 66

F/2. Vertetim për punësim - 50

F/3. Vertetim për SNS - 24

F/4. Vertetim për fitim të shtetësië - 29

F/5 Vertetim për humbje/fitim të shtetësië - 2

G. Nëna e cila potencialisht do të braktisë fëmijën e saj –

H. Nëna e cila e ka braktisur fëmijën e saj -2

I. Babai i cili ka braktise fëmijën e tij - 2

J. Regjistrimi i më vonshëm I fëmijëve

K. Arsyeje tjetër - 17

Për këto raste janë ofruar shërbime të ndryshme të kategorive sociale si: vizita në shtëpi, intervista, intervenime dhe bashkëpunim ndërinstytucional.

Kemi pasur bashkëpunim të ndërsjellët me Organizata Qeveritare dhe jo Qeveritare, siq është OFAP-i , UNICEF-i, SOS- Fshati, KOM, bashkëpunim me DPSF, Komunën, Policinë e Kosovës Gjykatat etj..

Drejtoria e Inspekcionit

Drejtoria e Inspekcionit, gjatë kësaj periudhe ka punuar me plan- programin e punës për këtë vit duke u bazuar në kompetencat të cilat janë derivat i Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative, Rregullore Komunale. Për këtë periudhë kemi kryer punë të përditshme që e karakterizojnë këtë drejtori.

Vërehet një ngritje e dukshme e kapaciteteve të punës në disa fusha krahasuar me periudhën e njëjtë të viteve paraprake.

Prioritet gjatë kësaj periudhe kohore i kemi dhënë:

- Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik (ZIVE).
- Pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve.
- Inspektimit në fushën e ndërtimeve.
- Inspektimeve në komunikacionin rrugor.
- Inspektimeve në lëmin e tregut
- Inspektimeve në mbrojtje të ambientit etj.

Raporti i punës së Drejtorisë së Inspekcionit është i përgatitur për secilin inspektorë veç e veç, ndërsa në vijim më në detaje janë të pasqyruara në formë tabelave dhe me përshkrim inspektimet për secilën lëmi.

Raporti i përgjithshëm gjashtë mujor i parë i punës për vitin 2025 në formë tabelave:

1.	Inspektime të përgjithshme - procesverbal për kontrollin inspektues	273
2.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Komunikacion	10
3.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Ndërtim	85
5.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Treg	136
6.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në M. Ambientit	42
7.	Aktvendim për ndalim të punimeve	19
8.	Aktvendim për rrënim	3
9.	Urdhër ekzekutimi për rrënim	1

10.	Aktvendim për shfuqizim- A. për ndalim të punimeve	6
11.	Aktvendim për gjobë mandatore	8
12.	Kërkesë për Gjykatë	4
13.	Kërkesë për kallxim penal	
14.	Njoftim për D.M.M	3
15.	Asgjësimit të produkteve -ATK	1
16.	Kërkesë për AVU- Inspektorin e Veterinës	1
17.	Raport final për Certifikata të përdorimit për objekt	6
19.	Pranim me komision për kushte higjieno sanitare -Pëlqim	47
20.	Refuzim i kërkesës Pëlqimit me komision për kushte higjieno sanitare	6
21.	Përgjigje në kërkesë me shkrim për palën	6
22.	Kërkesë për asistencë P.K-S.Policor Obiliq.	7
23.	Rekomandim për DSHPE	3
	Kërkesë për DSHPE	5
24.	Përgjigje për M.P.M- njësinë veçantë	1
25.	Ne proces	0
26.	Miratuar	169
27.	Refuzuar	9
28.	Hedhur poshtë	2
29.	Totali	180

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

- Përgatitja dhe hartimi i Planit të Punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2025
- Formimi i Këshillit Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2025
- Përgatitja e planit të prokurimit dhe planit të shpenzimit për projektet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
- Dorëzimi i paramanave dhe parallogarive të dy projekteve:
 “ Mirënjohje dhe material përcjellëse për DKRS-në” dhe “Ushqim, Pije dhe materiale plastike për serivim”
- Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve monitoruese të përfitueseve nga Thirrja Publike, te tri sektorëve.
- Përgatitja e Thirrjes Publike për subvencionim nga DKRS-ja për vitin 2025
- ***Shënimi i 16- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës***
 - Për nder të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo ditë me një sërë aktivitete;
 - Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.
 - Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
 - Manifestim Qendror i organizuar nga DKRS-ja në Shtëpinë e Kulturës” Xhavit Haziri”
- ***Shënimi i ngjarjes historike: “Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës”5,6,7 Mars***
- Seancë Solemne nga Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit
 - Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.
 - Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

- Në bashkëpunim me UNDP-në janë mbajtur takime pune për realizimin e projektit të iniciuar nga UNDP-ja “ **Industritë Kreative**” i cili si i tillë ka për qëllim: Hartëzimin e Institucioneve Kulturore në Komunën e Obiliqit.
- Janë kryer edhe shumë punë tjera në suaza të takimeve dhe çështjeve administrative.

Biblioteka e Qytetit

Në Bibliotekë e Qytetit ka vijuar puna e rregullt, njëkohësisht, kemi bashkëpunuar me dashamirës të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtarë , në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexushmërisë.

Aktivitetet kulturore në Shtëpia e Kulturës “ Xhavit Haziri”

AKTIVITETET KULTURORE, RINORE DHE SPORTIVE – PRILL– QERSHOR 2025

5 Prill

- **Aktivitete me KFOR-in Zviceran dhe fëmijët me nevoja të veçanta**, në bashkëpunim me organizatën “Dëgjo Zërin Tim”.
- **Finalja e dytë e turneut “Play-it”** – ndeshja mes Grepeland dhe KEK-ut, në palestrën “Adem Jashari” në Obiliq.

Homazhe përkujtimore

- Në varrezat e Dëshmorëve të Kombit – Ferid (Esat) Curri.
- Pranë pllakës përkujtimore në fshatin Graboc, në nderim të Dëshmorit të Kombit, Fejzullah (Sokol) Grajçevci.
- Pranë pllakës përkujtimore të Dëshmorit, Murat (Sahit) Krasniqi.

Dita Ndërkombëtare e Librit

- U shënua me aktivitete të shumta. U mbajt një **takim letrar**, i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Gjimnazin “17 Shkurti”.

26-vjetori i rënies së Dëshmorëve të Kombit

- Afrim (Rrahim) Krasniqi, Lutfi (Latif) Krasniqi dhe Agron (Shaban) Gashi.

5 Maji – Dita e Dëshmorëve të Kombit

- **Akademi përkujtimore**, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, z. Xhafer Gashi, dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- **Homazhe në nderim të Dëshmorëve të Kombit:**
 - Hasan Hasani
 - Mustafa Kastrati
 - Bahri Fazliu
 - Hamdi (Ismet) Krasniqi
 - Martirët e familjes Aliu

Gara ndërkombëtare “Kastrioti Open 2025” në Golesh.

Premiera teatrale: “Vdekja trokët” nga Woody Allen

Regjia: Xhemajl Luta

1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

- Një ditë e veçantë për fëmijët, organizuar nga Komuna e Obiliqit, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në bashkëpunim me Qendrën Rinore – Obiliq.

Gurthemeli për pishinën gjysmë-olimpike

Dita e Çlirimit të Komunës së Obiliqit

- Shënohet nën patronatin e Kryetarit të Komunës dhe përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- **Krisma e parë e lirisë – 11 Qershori** në fshatin Hamidi
- **14 Qershori – Dita e Çlirimit të Obiliqit**

Promovimi i librit “Fshati i Harruar” nga autori Aris Çerkezi.

Shfaqja teatrale “Leximi – Çelësi i Botës”

Realizuar nga Teatri i Qytetit të Obiliqit, në kuadër të projektit:

“Forcimi i cilësisë së shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe stimulimit të hershëm në shtëpi për fëmijët e vegjël në Kosovë”, mbështetur nga UNICEF.

DREJTORIA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

Aktivitetet të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të drejtorisë:

1. **Monitorimi i gjendjes mjedisore;** ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës përmes raporteve mujore nga TC-A, TC-B, Divizionit të Qymyrit dhe raportit të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK), dhe monitori i vendosur në qendër të Obiliqit (sheshi Aziz Zhilivoda) dhe raporti i mjedisit i zhvilluar për matjen e zhurmës ajrit dhe pluhurit nga DMM-ja.

2. **Aktivitetet ditore që janë të përfshirë në Kompaninë Komunale NPL Kastrioti**

“Mirëmbajtja e parqeve, shesheve, hapësirave gjelbëruese punohet në baza ditore, ndërsa punët tjera sipas kërkesave në teren.

- Kontratat me NPL –në Punët të cilat duhet të realizohen për parqet dhe sheshet në menaxhimin dhe punët e kryera në teren:
- ✓ Aktivitetet ditore mirëmbajtja e parqeve kositje, mbledhja e mbeturinave dhe zbrazja e shportave, prashitja e drujve dhe ujitja, mirëmbajtja e lodrave, pastrimi i kubzave etj.
- ✓ Krasitja e drujve dekorativ gjatë rrugëve, ujitja prashitja.
- ✓ Kositja e barit në zonat gjelberta dhe përgjatë rrugëve.
- ✓ ndërsa punët tjera sipas kërkesave në teren.

Fusha e inspektimeve

- ✓ Inspektimet ditore –respektimin e ligjit dhe udhëzimeve për mbeturinat, transporti i tyre e të ngjashme, inspektimet në biznese, dhe ndotja e mjedisit
 - ✓ Organizimin për Shënimet e ditëve mjedisore –
 - ✓ Inspektimet Deponisë Sanitare Mirash, dhe deponive të ngjashme
 - ✓ Monitorim dhe inspektim KEK-unë
- **Shënimet e ditëve mjedisore** – në bashkëpunim me DSHPE, NPL “Kastrioti” Sh.A dhe KRM “Pastrimi”, janë shënuar aktivitetet e ditës së tokës, aksioni “Ta pastrojmë Kosovën” 22 prilli dita e tokës etj.
 - Gjatë këtij viti janë mbajtur trajnime në bashkëpunim me UNDP, GIZ dhe MMPHI në fushën e mjedisit dhe shkëmbim të përvojave, gjithashtu takime dhe trajnime në fushën e Energjisë së Ripërtitshme.
 - **Ridërgimi i Projekteve në KEK** për vitin 2025 janë punuar (hartuar) projekte drejtuar KEK-ut;
 - Mbjellja e drujve (në Mazgit),
 - Parku në Breznicë,
 - Projekti i ekoulseve me sistem gjelbërimi,
 - Pastrimi i prockës Obiliq i vjetër.
 - Në kuadër të kompetencave që ka DMM ka reaguar (vepruar) në lidhje me KEK, gjithnjë duke u bazuar në raport të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK) dhe monitori i vendosur

në qendër të Obiliqit (sheshi “Aziz Zhilivoda”). Dhe raporti i pavarur i organizuar nga Komuna

- **Reagimet dhe shkresat zyrtarë dërguar Korporatës Energjetike të Kosovës**

Drejtoria e mjedisit ne baze te kompetencave qe ka reaguat me shkresa zyrtare dërguar Ministrive përgjegjëse KEK ne lidhje me ndotjen enorme ne komunën e Obiliqi kjo dëshmohej edhe me raportim nga instituti i pavarurë qe ka realizuar drejtoria e mjedisit, shqetësimet dhe kërkesat e qytetareve rrejte sociale dhe mediat.

Fusha Raportimi dhe plani i veprimit:

DMM për vitin 2025 ka hartuar plani e punës

- DMM ka hartuar planin për kontroll dhe inspektim për të gjithë operatorët që veprojnë në Obiliq,

DMM- gjatë kësaj periudhë tre mujore ka kryer dhe (shqyrtuar) edhe këto aktivitetet:

- Pranuar 34 kërkesa te llojeve te ndryshme
- 19 kontrollime të ndryshme Rutinore - të planifikuar, (plani)
- 13 vërejtje verbale
- 26 inspektime – sipas kërkesave të qytetarëve(lloji inspektimit) .
- Janë shqyrtuar 34 kërkesa
- Leje mjedisore 5
- Pëlqime dhe përgjigje ne kërkesa te qytetarëve te llojeve te ndryshme

Gjithashtu zyrtarët e DMM-së kanë qenë të angazhuar edhe me projekte të drejtorive tjera, duke bërë vlerësim, menaxhim, pranim teknik, subvencione etj.

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në Drejtori nga 01.01.2025 deri 30.06.2025

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke u mbështetur në kompetencat të cilat derivojn nga ligji për vetëqeverisje lokale, e ngarkuar me punët nga statuti i Komunës ka realizuar detyrat e hartuara për vitin 2025.

Duke i dhënë prioritet zhvillimit të bujqësisë, mbështetja ka filluar me përkrahjen e ekonomive të familjare bujqësore, dhe rritjen e interesimit të qytetarëve për qasje me konstruktive në këtë lëmi.

AKTIVITETET E PUNËS

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm potencial për zhvillimin ekonomik, për këtë arsye kemi vazhduar me projektet si:

Në tabelë është paraqitur ndarja e subvencioneve për vitin 2025.

Vaksionimi kafshëve të imta Insiminimi artificial i gjedheve ,trajtimi edometritit dhe anestusit të gjedheve	19,995.00
Vaksionimi dhe trajtimi i Qenve Endacak	13,482.00
Subvencionimi për ujitje nga sistemi “Ibër Lepenc” Ne proces	
Furnizimi me Pajisje Bujqësore në proces	
Total:	33,477.00

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale

Drejtoria e Infrastrukturës lokale gjatë gjashtëmujorit që po raportojmë ka qenë e angazhuar në përgatitjen paramasave dhe projekteve për projekte të ndryshme, mbikëqyrje të projekteve dhe shqyrtimi e kërkesave të ndryshme.

-Në projektin **“Koogjenerimi-Shtrirja e Rrjetit te Sistemit te Ngrohjes Qendrore Obiliq”**, Projekti ka përfunduar, është bërë raporti përfundimtar i kryerjes së punimeve nga Kompania mbikëqyrëse e projektit dhe menaxheri i kontratës. Obligime kontraktuale në këtë kontratë janë: 907,546.00€.

-Në projektin **“ Koogjenerimi-mbikqyrja e realizimit të punëve për projektin e instalimit te rrjetit të sistemit të ngrohtores së qytetit nëpërmjet sistemit te koogjenerimit”**,Projekti ka përfunduar, është bërë raporti përfundimtar i kryerjes së punimeve nga menaxheri i kontratës. Obligime kontraktuale në këtë kontratë janë: 31,216.40€.

-Në projektin **“ Mbikëqyrja e projekteve të shtrirjes, pompave dhe nënstacioneve të sistemit të Koogjenerimit”** lënda është në proces të vlerësimit.

-Në projektin **“Instalimi i ngrohjes qendrore në qytetin e Obiliqit – Koogjenerimi –“Faza e II-vazhdimi i shtrirjes së rrjetës së ngrohjes qendrore”**. i kemi filluar procedurat e prokurimit me dt.05.05.2025.

-Në projektin **“Ndërtimi i pishinës gjysmë olimpike-ndërtimi i pishinës në Komunën e Obiliqit”**, kontrata është nënshkruar dhe është vënë gurthemeli i pishinës me dt.03.06.2025.

-Në projektin **“Ndërtimi I dy nënkalimeve për këmbësorë”**, Është punuar në ndërtimin e trotuareve për rreth strukturave të nënkalimit 1 dhe 2. Kubëzat janë përfunduar, në dy nënkalimet duhet ti ndërtojmë edhe nga 2 ose 3 shkallë për të krijuar hyrjen dhe daljen sa më të lehtë në nënkalim. Pas përfundimit të tërësishëm të trotuareve do të fillojmë me veshjen e strukturës me pllaka të mermerit.

-Ne projektin **“Bashkëfinancim me MMPHI-ën-Ndërtimi i rrugës dhe kanalizimit fekal ne rrugën Avni Rrustemi- Obiliq”** – projekti ka përfunduar dhe është në fazën e pranimi teknik të projektit.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me MMPHI-ën -Rikonstruimi i trotuarit dhe shtegut për biçikleta në rrugën “Hasan Prishtina ”deri te Kosova -A**, punimet kanë vazhduar me montimin e skajoreve, shtrirjen dhe ngjeshjen e zhavorrit në pjesën tjetër të rrugës. Po ashtu e kemi asfaltuar shtegun e biçikletave në anën e majtë të rrugës.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me MMPHI-ën -Rikonstruimi i rrugës Dardhishtë--Fushë Kosovë ,Obiliq**, e kemi përfunduar asfaltimin e rrugës, janë duke u sanuar disa pjesë të trotuarit dhe rregullimi i pusetave, pastaj do të bëhet pranimi teknik.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me MAPL-ën - Rikonstruimi i rrugës Obiliq – Mazgit i epërm”** pasi është asfaltuar pjesa A ose pjesa nga tyrbet deri në kodër të qytetit punimet janë duke u zhvilluar në pjesën e trotuareve të pjesë B.

Në projektin **“Bashkëfinancim me MAPL-ën “Pushka e Parë” dhe “Ali Gollaku”**. Janë asfaltuar te dyja rrugë, na ka mbetë pa asfaltuar pjesa te kanali i Ibër Lepencit.

- Në Projektin **“ Bashkëfinancim me DEMOS-in- “Asfaltimi i rrugëve dhe kanalizimi në fshatin Babimoc”** Punimet e kanalizimit kanë përfunduar dhe tash do të asfaltohen edhe rrugët të cilat janë të parapara me kontratë.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me DEMOS-in -Asfaltimi i rrugëve rurale në fshatin Mazgit** – janë duke u përgatitur rrugët për asfaltim.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me Ministrinë për kthim dhe komunitete:1.Rregullimi i rrugës Stara Qesma dhe rruga Lazarevo në Pletetin, dhe 2.Rregullimi i segmenteve të rrugës Hakif Dedinca në Lajthishtë”**, rruga Llazarevo dhe Stara Çesma janë asfaltuar, janë trajtuar me zhavorr segmentet e rrugë Hakif Dedinca në Lajthishtë dhe presim shpejt të fillojmë me asfaltim.

-Në projektin **“Ndërtimi i kanalizimit në Lajthishtë”** Punimet në këtë projekt kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik.

-Në projektin **“Ndërtimi i Urës në Grabovc”** ndërtimi i urës ka përfunduar po ashtu është bërë edhe përgatitja e rrugëve për asfaltim.

-Në projektin **Bashkëfinancim “ Mbindërtimi i Objektit të QKMF Obiliq”**, në bazë të memorandumit janë planifikuar 110,000.00€ janë paguar 55,000.00€. Punimet janë ndërprerë dhe nuk kemi kurrfarë informacione pse punimet nuk po vazhdojnë.

I kemi proceduar në zyrën e prokurimit edhe projektet:

-
1. Asfaltimi i rrugës të Sekriaq në Mazgit dhe rruga Dardania seg.1 Milloshevë
 2. Ndërtimi i rrugës dhe trotuari rr. Daut Hashani
 3. Ndërtimi i kanaletës Breznicë
 4. Ndërtimi i këndit të lojërave afër fushave sportive në Dardhishtë

Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi

Drejtoria e DPUPK është e ndarë në katër sektorë, sektori i Urbanizmit, Pronës dhe Çështjeve pronësore juridike, Kadastrit dhe Gjeodezisë, ku secili nga këta sektorë është i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme. Të gjithë sektorët janë duke i përmbushur me përkushtim të plotë duke i respektuar normativat ligjore në fuqi dhe afatet ligjore, duke u ndarë të kënaqur edhe me qytetarët edhe me vetë eprorët që vazhdimisht raportojnë për punët e përfunduara dhe ato të cilat janë në proces të përfundimit.

Kështu që puna e kryer gjatë gjashtë muorit Janar - Qershor ka qenë një punë produktive edhe pse është pjesa e parë e vitit nuk kanë qenë aq voluminoze por si të tilla do t'i paraqesim në vijim :

-SEKTORI I PRONËS-

Gjatë këtij Gjashtë muori Janar - Qershor **Sektori i pronës** dhe çështjeve pronësore juridike në kuadër të DPUPK-së ka qenë e ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që janë paraparë të kryhen e të cilat do t'i paraqesim në vazhdim :

Me iniciativën e Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër pas plotësimit të kushteve ligjore ka përgatitur 5 (pesë) Propozim vendime për dhënien në shfrytëzim në periudhë afatgjatë për 99 vite pronën e paluajtshme komunale , të cilat ende janë në pritje për konfirmimin e ligjshmërisë nga MAPL.

Gjatë periudhës gjashtë mujore Janar – Qershor 2025 kemi pas kërkesa të lëndëve të ndryshme të cilat bien në kuadër të fushë veprimtarisë së DPUPK-së dhe atë si në vijim:

<i>1.Kontratë e Shitblerjes</i>	<i>470</i>
<i>2.Kontratë për Ndarjen e Paluajtshmërisë</i>	<i>8</i>
<i>3.Aktvendim i Trashëgimisë</i>	<i>73</i>
<i>4.Regjistrim i Hipotekës</i>	<i>65</i>
<i>5.Fshirje e Hipotekës</i>	<i>37</i>
<i>6.Kontrata të Faljes (Dhurimit)</i>	<i>190</i>
<i>7.Parcelizim (Ndarje)</i>	<i>111</i>
<i>8.Bashkim i Parcelave</i>	<i>5</i>
<i>9.Rregullim i Kufijve</i>	<i>4</i>
<i>10.Regjistrim i Objektit</i>	<i>16</i>
<i>11.Regjistrim Shpronësimi</i>	<i>7</i>
<i>12.Modifikim për Person</i>	<i>125</i>
<i>13.Vendime Gjyqësore</i>	<i>3</i>
<i>14.Kontrata të Qiramarrjes për 99 vite</i>	<i>5</i>
<i>15.Kontrata të Këmbimit (Ndërrimit)</i>	<i>13</i>
<i>16.Historiat i Pronës</i>	<i>9</i>
<i>17.Regjistrim i Barrës Tatimore</i>	<i>17</i>
<i>18.Vendime për mbajtje të Përjetshme</i>	<i>01</i>
<i>19.Azhurim i Gjendjes në Grafik</i>	<i>00</i>
<i>20.Lirim nga Barra Tatimore</i>	<i>8</i>
<i>21.Urdhër për shënim nga Përmbaruesi</i>	<i>1</i>
<i>22.Marrëveshje Ndërrimetësimi</i>	<i>4</i>
<i>23.Lirim i shënimit të Përmbarimit</i>	<i>5</i>

RAPORTI GJASHT MUJOR -2025			
	çertif.paluajtshmeris	Kopje plani	çert.gjendj pronsore
kerkesa	723	662	368
te realizuara	707x2	655x2	41x1
Procedurë	0	0	0
me bllok	2	2	0
lirume	14	5	327
totali	1414€	1310€	41€
totali I pergjthshem	2765€		

Te Hyrat Vjetore Janar-Qershor 2025 në Sektorin e Gjeodezisë Pronë dhe Kadastër janë: 28,625 € + 2765 € Cert. paluajtshmerisë , Kopje Plani dhe Cert. gjendje pronësore , Gjithsejtë të hyra = 31,390 €.

- Numri i Bartjes së Pronës në emër të dy Bashkëshortëve ka qenë 19 ;
- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Burrave 102 dhe;
- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Grave 29 .

-SEKTORI I KADASTRIT-

- Si pikënisje Sektori i Kadastrit kujdeset për respektimin e ligjeve dhe mban përgjegjësi në zbatimin e ligjeve të Kadastrit dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), dhe se bashku me ta krijojnë metoda në avancimin e metodave të punës.
- Gjatë këtij gjashtë mujori Janar – Qershor 2025 kemi punuar në realizimin e të gjitha kërkesave për qytetarët e Komunës, varësisht prej llojit dhe natyrës së kërkesave të qytetarëve.
- Zhvillimin e procedurave të regjistrimit , sipas detyrës zyrtare dhe kërkesës së palëve;
- Korrigjimin e regjistrimit në Sistemin Informativ Kadastral të tokave të Kosovës (SIKTK) sipas procedurave dhe zbatimin e të gjitha dispozitave ligjore në fuqi;
- Regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe regjistrimin e pronave komunale;
- Azhurimin e pronave në bazë të dokumentacionit të lëshuar nga Gjykatat kompetente, Noterët, Përmbaruesit si dhe organet përgjegjëse Vendimet e Kuvendit, Vendimet nga AKK-ja si dhe vendime tjera etj;
- Zbatimin e procedurave rreth transaksioneve të pronave private dhe shoqërore në SIKTK-së ;
- Shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e paluajtshmerisë ish-pronarit, evidentimin dhe shlyerjen e masave të përkohshme sipas aktvendimit të Gjykatës kompetente;
- Udhëheqjen me kadastrë etazhë të banesave, ndërtesave, pjesëve të ndërtesave si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë ndërtuar banesat;
- Regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave ; Aktvendimeve mbi regjistrimin e servituteve, regjistrimin e barreve tatimore;
- Lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmëri, certifikatave mbi të drejtat e pronës së paluajtshme si dhe kopje planit;
- Mirëmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve ,fshatrave ,shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;
- Nxjerrjen e aktvendimeve për miratim e ndarjeve të parcelave, bashkimin e parcelave modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave;
- Nxjerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara;
- Përgatitjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin punës;
- Pune të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe institucioneve tjera).
- Zhvillimin dhe organizimin e sistemeve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale , modelin e sistemit informatikë për tokën dhe pronën;
- Regjistrimin e ndarjeve të parcelave dhe modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.
- Kryerjen e punëve profesionale , të cilat dalin nga shërbimi gjeodezik (ndryshimet e bëra gjatë matjeve nga Hartat e Kosovës dhe bartjen e tyre në programin e SIKTK-së.
- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhënie të koordinatave për teren);
- Si dhe Shërbime profesionale dhe shërbime të tjera ,për subjekte dhe institucione të ndryshme;

- Si dhe për fund kemi marr pjesë ne trajnime, seminare te ndryshme per zhvillimin e njohurive qe te jemi sa më transparent ne kryerjen e shërbimeve ndajë qytetarëve te Komunës.

- Ne përfundim te këtij raporti për gjashtë mujorin Janar - Qershor konstatojmë se kemi arrit t'i përfundojmë varësisht prej natyrës se lëndëve, Kontrata te ndryshme, ndarje te parcelave, bashkimin e parcelave, modifikimin e attributeve te parcelave, ndërtesave pjesëve te ndërtesave apo refuzim te kërkesave Vendime te ndryshme etj.

-SEKTORI I GJEODEZISË-

Raporti përmban një përmbledhje ne vija te trasha te punëve gjate periudhës gjashtëmujore për vitin 2025. Ne raport do te përfshihen punët e përfunduara nga sektori ne aspektin profesional sipas kërkesave te parashtruara nga ana e drejtorive te KK Obiliq te cilat lidhen drejtpërdrejt me pune profesionale ne teren e qe janë situacione te ndryshme për nevoja te projektimit. Matje te parcelave – kufijve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve, elaborate te shpronësimit dhe identifikime te ndryshme me matje.

Ne cilësinë e anëtarit te komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore ka pas pak aktivitet për shkak të mungesës së kërkesave për leje ndërtimore pasi qe hartat zonale ende nuk janë përfunduar

Pasqyra e lendeve te përfunduara ne kuadër te mirëmbajtjes se rregullt te kadastrit do te paraqitet me një tabele te veçantë dhe do ti bashkëngjisë këtij raporti ndërsa ky raport me shkrim do te përfshije vetëm punët dhe shërbimet qe janë kryer sipas kërkesave te Drejtorive brenda komunës. Gjate periudhës gjashtëmujore 2025 është punuar ne legalizimin e objekteve sipas ligjit për legalizim, objektet të cilat marrin Vendimin për Certifikatë të Legalizimit regjistrohen në pjesën grafike dhe tekstuale te Kadastrit, në këtë proces janë legalizuar objekte ne baze te Vendimit për Certificate te Legalizimit gjithsejtë sipas zonave kadastrale me sa vijon:

- zk Babimoc.....4 (katër) objekte
- zk Millosheve.....2 (dy) objekte
- zk Obiliq.....7 (shtatë) objekte
- zk Llazarevë.....1 (një) objekt

Gjithsej **14 objekte** te regjistruara ne kadaster ne procedure te legalizimit dhe procedure te rregullt ne baze te lejes ndërtimore dhe aktvendimit për certifikatë të përdorimit.

Me kërkesë të Drejtorisë së Infrastrukturës, gjatë periudhës gjashtëmujore janë realizuar punë nga fusha e gjeodezisë inxhinierike dhe kadastrës, duke përfshirë matje për kanalizime dhe përcaktimin e kufijve të rrugës për punim. Janë zhvilluar aktivitete intensive me përfaqësuesit e KEK-ut për përcaktimin e rrugës qarkore, si pasojë e atakimit të rrugës ekzistuese nga zgjerimi i minierës. Gjithashtu, janë trajtuar lëndë në pjesën grafike për mirëmbajtjen e rregullt të kadastrit

-SEKTORI I URBANIZMIT-

-Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 sektori i **urbanizmit** në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesëmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto fushëveprime janë përmbyllur me sukses gjatë këtij gjashtëmujori.

-Plotësimi i formularëve të performancës kërkesë nga komisioni komunal i performancës.

-Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.

- 41 vendime për leje ndërtimore,
- 3 certifikata të përdorimit,
- 2 vendim të refuzimit,
- 7 përgjigjeje palëve,
- 2 njoftime për qytetarë në kërkesat e ndryshme.

- 7 vendime të legalizimit të objekteve

- 8 vendime të legalizimit për listë të pritjes.

Të hyrat nga lejet ndërtimore : 77,562.07 euro

Të hyrat nga legalizimi i objekteve: 5,918.5 euro

T O T A L 83,481.02 **EURO**

Sektori i Urbanizmit :	83,481.02 €
Sektorët - Gjeodezi Pronë dhe Kadastër :	31,390 €
Totali :	114,871€

Njësia e Burimeve Njerëzore

Duke u mbështetur në planifikimin e burimeve njerëzore si dhe planin e punës për vitin 2025 Njësia e Burimeve Njerëzore ka për qëllim zbatimin e planit të punës.

Plani i punës për vitin 2024 përmban bazën ligjore, strukturën organizative të Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNJ), detyrat, përgjegjësit objektivat të cilat realizohen përmes aktiviteteve, indikatorëve, përgjegjësve dhe afateve kohore. Kjo mundëson zbatimin më të lehtë të këtij plani dhe monitorimin e tij.

Gjatë muajit Janar / Qershor / 2025 kemi zhvilluar këto procedura :

- Planifikimi i personelit për vitin 2025.
- Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2024

Emërimet

Janar /Naim Miftari / caktohet UD i drejtorit të administratës nga data 06.01.2025 deri me dt 14.02.2025.

Prill / Brikenda Pllana / emërohet drejtoreshë në DSHMS nga data 22.04.2025 .

Prill / Ermal Duraku / emërohet zyrtar administrativ në Kabinetin e Kryetarit nga data 24.04.2025.

Prill / Naim Miftari caktohet UD i drejtorit të inspektionit nga data 28.04.2025 deri me datën 16.05.2025.

Maj / Rafet Mehmeti /emërohet drejtor në drejtorinë e inspektionit nga data 19.05.2025.

-Lirim nga detyra

-Visar Pllana Drejtor i Inspektionit i liruar nga detyra nga data 14.04.2025.

-Blerona Shabanaj Mehmeti Drejtoreshë e DSHMS e liruar nga detyra nga data 16.04.2025.

-Ardenis Alija Zyrtar Administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës nga detyra nga data 15.04.2025.

Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës :

-Armend Mirena.

-Ardianë Gërvalla Arifi

Pensionim :

-Sherif Hoti pensionim 04.02.2025

-Mehmet Ismaili pensionim me dt.04.07.2025.

- Rekrutim – Pranim nga jashtë :

-Zyrtar për paga i hapur me dt.15.01.2025 i mbyllur 13.02.2025 /i punësuar Ardenis Alija me dt.16.04.2025.

-Udhëheqës i sektorit për ekonomi i hapur me dt. 18.01.2025 i mbyllur me 16.02.2025 ka përfunduar me dt.12.03.2025 kandidatët nuk u paraqitën në testin me shkrim .

- Udhëheqës i sektorit për ekonomi i hapur me dt. 23.04.2025 i mbyllur me 22.05.2025 në procedurë të ankesës .

-Zyrtar për lektorim i hapur me dt. 23.05.2025 i mbyllur me 21.06.2025 në procedurë.

- Auditor i brendëshën i hapur me dt.22.05.2025 i mbyllur me dt.20.06.2025 asnjë kandidatë nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit .
- Zyrtar administrativ i hapur me dt. 05.06.2025 i mbyllur me 04.07.2025 në procedurë.

-Periudhës provuese :

- Driton Dobratiqi periudhë provuese 12.08.2024 deri me dt.11.02.2025 .
- Melihate Kasabqi periudhë provuese nga data 09.08.2024 deri me dt.08.02.2025.
- Marigona Berbativci periudhë provuese nga data 12.08.2024 deri me dt.11.02.2025.
- Mimoza Hashani periudhë provuese nga data 03.09.2024 derime dt. 02.03.2025.
- Ardenis Alija periudhë provuese nga data 16.04.2024 derime dt. 16.10.2025.

-Përgjigje në Ankesat e paraqitura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

- Mexhit Krasniqi me dt.21.01.2025 ankesë kundër rezultateve përfundimtare për Drejtor të QPS.
- Arta Alaj me dt.13.03.2025 ankesë kundër vlerësimit të rezultateve në punë .
- Mehmet Ismaili me dt.14.03.2025 ankesë për shkeljen e të drejtës në pagë.
- Kushtrim Mirena me dt.13.03.2025 ankesë për shkeljen e të drejtës në pagë.
- Azize Zeneli me dt.12.03.2025 ankesë për shkelje e të drejtës në pagë .
- Jasmina Radanovic me dt.25.03.2025 ankesë për shkelje e të drejtës në pagë .
- Ardianë Gërvalla me dt.07.05.2025 ankesë kundër Vendimit për ndërprerje .
- Fazli Pervetica me dt.14.05.2025 ankesë për shkelje e të drejtës në pagë.
- Gentrit Hashani me dt.13.05.2025 ankesë ne procedurën e rekrutimit zyrtar i larë për teknologji / Arsim
- Armend Mirena me dt.05.06.2025 ankesë kundër Vendimit për ndërprerje.
- Besfort Kurshumliu me dt.05.06.2025 ankesë lidhur me detyrat e punës .
- Një grup i zyrtarëve komunal me dt.10.06.2025 ankesë për kompensim material /pagesën për pervojën e punës me 0.5%.

-Vendime të SKPM / :

- Anulohet Konkursi per Drejtor të QPS sipas Vendimit SKPMSHCK me NR.2176/2025 i dt.01.04.2025 .
- Hudhet poshtë si e parakohshme ankesa për Kushtrim Mirena me Vendimin me Nr.2678/2025 i datës 22.04.2025.
- Dy anëtar të këshillit kanë Hudhë poshtë si të parakohshme ankesën për Jasmina Radanovic me Vendimin me Nr.2905/2025 i datës 30.04.2025, dhe një anëtarë ka shprehur Mendim Mospajtues i dt.30.04.2025.
- Refuzohet si e pa bazuar ankesa për Mehmet Ismaili i datës 08.05.2025 me Nr.3087/2025 i datës 05.05.2025.
- Aprovohet ankesa nga Arta Alaj lënda kthehet në rivlerësim rivendosje me dt.04.06.2025.
- Hudhet poshtë si e parakohshme ankesa nga Azize Zeneli 04.06.2025 .

Zyra ligjore

Shërbimet ligjore të ofruara:

-**Këshilla juridike** ,për zyrën e Kryetarit, Drejtoritë komunale, sektoret ,auditorin e brendshëm, zyrën e personelit në përpilimin e akteve juridike,vendime,procedurat e shpronësimit,rregulloret komunale të aprovuara në kuvend sipas propozimeve të drejtorive.

-Përpilimin e kontratave ,memorandumeve për zyrën e kryetarit dhe për të gjitha drejtorite, përpilimin e shkresave të ndryshme etj.

-Shqyrtimin e kontratave të propozuara nga ana e drejtorive për bashkëpunim me organizatat e ndryshme para se të bëhet nënshkrimi i tyre.

-Përpilimin e vendimeve sipas kërkeses se Kryetarit dhe Drejtorive.

Përfaqësimet :Në bashkëpunim me Zyrtaret Ligjore dhe avokatin janë bërë mbi **994 veprime** juridike –gjyqësore duke përfshirë Padite, shkresa ,përgjigje në padi,parashtresa të ndryshme për gjykatë, mbajtje të seancave gjyqësore si dhe sigurim të provave sipas kërkesës së gjykatave,prapsime tek permbaruesi menaxhimi i kontratës dhe shume veprime tjera.

-Pranimi i të gjitha lëndëve gjyqësore përmes arhivës ,shqyrtimin e tyre ,regjistrimin në regjister te evidences si dhe kompletimin e lendeve per ti dorëzuar tek avokati.

Pregatitja e raportit per shpenzime kontigjente per vitin 2025 të bartura nga viti 2024, në këtë raport nuk janë përfshirë kontestet të cilat nuk ju dihet vlere deri ne marrjen e ekspertizes si dhe kontestet pronesore qe kanë të bëjnë me vërtetim prone.

Poashtu në këtë vitë si zyre ligjore kemi punuar ne hartimin e listes se lendeve gjyqesore te ndara ne llojet e ndryshme te kontesteve duke pefshire me gjeresisht Kontraten Kolektive te Arsimit.

Ky raport ka pershire lendet Gjyqesore të përfunduara dhe njekohesisht te paguara nga DEFZH, dhe poasshtu lendet të cilat janë të përfunduara me verdikt gjyqesor por te njejtat nuk jane paguar, si dhe te gjitha lendet te cilat jane te procedure gjyqesore.

-**Përcjelljen e ligjeve** ,Rregulloreve dhe udhëzimeve administrative përmes ueb faqeve të Kuvendit të Republikës Kosovës dhe Qeverisë.

-**Pjesmarrje ne takimet** e rregullta të kolegjiunit të zyrtarëve ligjor në kuadër të Asociacionit të Komunave të Rrepublicës së Kosovës

-**Hartimi i raportit për shpenzime kontigjene** për DEFZH dhe auditorin gjeneral

-**Këshilla për zbatimin e ligjeve, rregulloreve** dhe udhezimeve administrative të cilat vijnë nga niveli qendror,sipas kërkesave të drejtorive .

-Pjesmarrje në mbledhjet e Kuvendin e Komunes ku në bashkëpunim me sekretarinë e Kuvendit dhe me kryesuesen bëjmë përpilimin e akteve të ndryshme nga fushëveprimtaria e Kuvendit Komunal.

-Takime të rregullta me Avokatin e Komunës, bashkëpunim dhe koordinim të punës në çështjet gjyqësore, përpilimin e përgjigjeve në padi dhe shkresa tjera, sigurimin e provave nga ana e drejtorive përgjegjëse për secilën lëndë që i përket atyre, pjesmarrje në seanca gjyqësore dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me të gjitha lëndët gjyqësore në cilësinë e palës paditëse dhe të paditur.

MEKANIZMI KOORDINUES KOMUNAL KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Mekanizmi Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje (MKKKDHF) në Komunën e Obiliqit, është themeluar me qëllim që të sigurojë një reagim të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës ndaj dhunës në familje, koordinim efikas të reagimit institucional për adresimin e rasteve të dhunës dhe të kontribujë në krijimin e politikave proaktive kundër dhunës në familje në Komunën e Obiliqit.

Objektiv e këtij mekanizmi është marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet Autoriteteve përgjegjëse në komunën e Obiliqit, për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare përmes institucionalizimit të Mekanizmit Koordinues (MK).

Baza ligjore

1.1. Marrëveshja e Mirëkuptimit bazohet në Ligje dhe akte tjera si në vijim:

- 1.1. Ligjin nr. 0/3-L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 76, datë 10.08.2010);
- 1.2. Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 04.06.2008);
- 1.3. Ligjin nr. 04 L- 017 për Ndihmë Juridike Falas (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 3, datë 22.02.2012),
- 1.4. Ligjin nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 41, datë 01.11.2008);
- 1.5. Ligjin nr 05/L-020 për Barazi Gjinore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16, datë 26.06.2015)
- 1.6. Ligjin nr 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17, datë 16.09.2011);
- 1.7. Ligjin nr 2004/4 për Shëndetësinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16, datë 01.08.2007) dhe Ligji nr. 03/L-124 për ndryshimin dhe Plotësimin e e Ligjit për Shëndetësi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 46, datë 15.01.2009);
- 1.8. Ligjin nr. 04/L-083 për Regjistrimin dhe Evidencën e të Papunësuarve dhe Punëkërkuesve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12, datë 15.05.2012);

- 1.9. Ligjin nr. 2004/32 për familjen i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 04, datë 01.09.2006);
- 1.10. Ligji nr. 05/L-036 – për kompensimin e viktimave të krimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19, datë 13.07.2012);
- 1.11. Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/2015, datë 30.06.2015);
- 1.12. Kodi nr./03-L-193 i Drejtësisë për të Mitur (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 78, datë 20.08.2010) dhe
- 1.13. Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje, së bashku me Planin e Veprimit për Dhunën në Familje etj.
- 1.14. Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë, Zyra e Kryeministrit- Agjensia për barazi Gjinore;
- 1.15. Udhëzimi Administrativ 12/2012 i datës 06.11.2012, për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje dhe
- 1.16. Udhëzimi Administrativ 02/2013 i datës 15.02.2013, për trajtimin e obligueshëm mjekësor të kryesit të dhunës në familje nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope.

- Takimet e rregullta:2
- Takimet në total :4(përfshir edhe takimet lidhur me aktivitetet e mekanizmit)
- Numri i fëmijëve të viktimave të mbështetur në kopsht:6
- Numri i viktimave të cilëve u është ofruar ndihmë juridike falas:2
- Numri i grave të cilat kanë marrë pako ushqimore(duke përfshirë edhe viktimat nga vitet e kaluara):34
- Numri i viktimave për të cilat është mbuluar pagesa e qirasë:1

Raporti i rasteve të dhunës në familje në mënyra tabelore Janar-Qershor 2025

1.	Numri i rasteve të proceduara në prokurori	16
2.	Numri i rasteve që kanë has në mirëkuptim në mes palëve	4
3.	Numri i rasteve në strehimore	Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 Është ofruar asistim /këshillim për L.F dhe dy

		nipërit e saj të cilët kanë qëndruar në strehimore gjatë vitit 2024
4	Numri i rasteve të fëmijëve në strehimore	Nuk është referuar asnjë rast për strehimore
5.	Numri i rasteve të grave në strehimore	Nuk është referuar asnjë rast për strehimore
6.	Numri i rasteve të dhunës në total	28

Rastet e dyshuara dhe rastet sipas gjinisë dhe etnisë janë si në vijim:

Përkatësia Gjinore:

Femra__ 27(viktima -21,te dyshuara-6), Meshkuj_32

Përkatësisë etnike:

shqiptar :35 serb: 0, turq:0 boshnjak____0, rom_17_, ashkali__7, egjiptian____0_,malazez--0
e të tjerë, dhe c) aftësisë së kufizuar-0